

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6380
E enjte, 5 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Qendra Wilson: Dialogu Kosovë - Serbi t'i vendosë njerëzit para territorit



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NUMRI I RASTEVE TË INFEKTIMIT ME COVID-19 NË KOSOVË NË MUAJIN GUSHT KA PREKUR SHIFRAT TRESHIFRORE

DYFISHOHEN RASTET ME COVID NË KOSOVË



Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 221 infektive të reja me Covid-19, ndërsa një person ka vdekur. Një ditë më parë ishin raportuar 110 raste

pozitive. Në total numri i rasteve aktive është 888. Ministria e Shëndetësisë ka treguar se në 24 orët e fundit janë dhënë 14 616 doza të vaksinës, ndërsa 162 807 qytetarë

janë vaksinuar me dozën e dytë të vaksinës. Numri i rasteve ka filluar të rritet në pjesën e dytë të muajit korrik, kur janë liruar pothuajse të gjitha masat kundër Covidit

AKTUALE



SHBA-ja PREMTON MILIONA VAKSINA PËR VENDET NË NEVOJË F. 2

HAXHIU: PËRGJIMET E LANSUARA DITËT E FUNDIT, TRONDITËSE PËR SISTEMIN E DREJTËSISË F. 5

OSMANI DEKRETON LIGJIN PËR AUTOMJETE DHE MARRËVESHJEN FINANCIARE PËR IPA 2020 F. 7

BULLIQI KËRKON MBËSHTETJE SHITESË NGA QEVERIA PËR PROJEKTET NË PODUJEVË F. 6



Kuvendi i Kosovës për gjashtë muaj shpenzoi mbi 3 milionë euro



Ismaili kërkon që të ndalohet finalizimi i planit zhvillimor për Prishtinën



EKONOMI



KOMISIONI PËR EKONOMI MIRATON EMRAT PËR BORDIN E RI TË AKP-së F. 8

MBAHET DËGJIMI PUBLIK MBI NISMËN LEGJISLATIVE "PROJEKTLIGJI PËR KRIPTOVALUTA" F. 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja premtion miliona vakcina për vendet që kanë nevojë

WASHINGTON, 4 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) do të fillojnë dërgimin e 500 milionë dozave të vaksinës "Pfizer/BioNTech" në 100 vende me të ardhura më të ulëta në fund të këtij muaji, njoftoi presidenti amerikan Joe Biden. Ai ka thënë se tashmë ShBA-ja ka dhuruar më shumë se 110 milionë doza të vaksinës. Biden ka theksuar se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të dhurojnë dhjetëra miliona doza gjatë verës, përfshirë 500 milionë të planifikuara, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara nuk presin asgjë në këmbim. "Ne nuk po i shesim. Këto donacione të vaksinave nga Amerika janë falas", ka thënë ai, duke folur në Shtëpinë e Bardhë më 3 gusht.

Presidenti Biden siguroi amerikanët se do të ketë më shumë vakcina në dispozicion dhe përsëri u bëri thirrje qytetarëve të imunizohen kundër sëmundjes Covid-19.

Ndër 65 vendet që kanë marrë vakcina nga ShBA-ja deri më tani janë Afganistani, i cili ka marrë 3.3 milionë doza; Pakistani, 5.5 milionë; Uzbekistani, 3 milionë dhe Ukraina, 2 milionë doza.

Në mesin e vendeve që do të përfitojnë vakcina nga ShBA-ja janë edhe Kosova dhe Bosnje e Hercegovina.

Në muajin maj Biden u zotua se ShBA-ja do të dhurojë të paktën 80 milionë vakcina në vendet në të gjithë botën. Ai tha më 3 gusht se ky premtim është përmbushur.

Shtetet e Bashkuara kanë dërguar dozat e vaksinës kryesisht përmes COVAX-it, një skemë globale e krijuar me qëllim të shpërndarjes së barabartë të vaksinave në vendet e varfra.

COVAX, i mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetit (OSh) dhe Aleanca Globale për Vaksinat dhe Imunizimin, thotë se ka nevojë për 2 miliardë doza deri në fund të vitit.

Pandemia ka vrarë të paktën 4.2 milionë njerëz në nivel global, përfshirë 613 679 njerëz në Shtetet e Bashkuara, më shumë se në çdo vend tjetër, e pasuar nga India me 425 000 vdekje të regjistruara, sipas të dhënave të publikuara nga Universiteti "Johns Hopkins".



Izraeli rivendos disa masa të kufizimit kundër pandemisë

JERUSALEM, 4 GUSHT - Kryeministri i Izraelit, Naftali Bennett, ka thënë të mërkurën se fushata e vaksinimit dhe vendosja e kufizimeve mund ta kursejnë vendin nga një izolim tjetër i përgjithshëm, pavarësisht se rastet e reja me Covid-19 po rriten. "Qëllimi ynë është që Izraelin ta mbajmë të hapur, mirëpo të mos arrijmë në një situatë të mbushjes së spitaleve. Për t'i parandaluar kufizimet më të ashpra, ne do të vaksinohemi, do të veshim maska dhe do ta mbajmë distancën", ka thënë ai gjatë një vizite në një qendër të re vaksinimi në Jerusalem. Qeveria izraelite njoftoi për një

sërë kufizimesh të reja të martën, duke përfshirë kërkimin e certifikatave të vaksinave ose testet negative për hyrje në vendet ku gjenden më pak se 100 persona dhe mbajtjen e maskës në ambiente të hapura ku janë më shumë se 100 persona.

Gati 60 për qind e 9.3 milionë qytetarëve të Izraelit kanë marrë dy doza të vaksinës, kryesisht "Pfizer/BioNTech". Por, rreth një milion izraelitë ende refuzojnë të vaksinohen edhe pse e gëzojnë këtë të drejtë.

Duke njoftuar kufizimet e reja, autoritetet paralajmëruan se varianti shumë më ngjitur

"Delta" i koronavirusit po përhapet me shpejtësi.

Zyrtarët shëndetësorë u bënë thirrje izraelitëve të "ndalojnë shtrëngimin e duarve, përqafimin dhe puthjen".

Izraeli kishte hequr shumicën e kufizimeve ndaj pandemisë në fillim të qershorit, por filloi të rivendoste disa prej tyre muajin e kaluar pas rritjes së rasteve të reja të të infektuarve.

Gjatë rreth dy javëve të kaluara, Izraeli ka regjistruar mesatarisht më shumë se 2 000 raste të reja në ditë dhe 229 persona janë në gjendje të rëndë në spitale. Shifra është më e larta që nga prilli.



Disa të plagosur nga një sulm në Kabul



KABUL, 4 GUSHT - Një zyrtar i sigurisë dhe dy civilë janë plagosur pas një shpërthimi pranë ndërtesës së Drejtorisë së Inteligjencës afgane në Kabul, ka njoftuar policia, pa dhënë detaje të tjera.

Shpërthimi pranë Drejtorisë Kombëtare të Sigurisë (NDS) ndodhi disa orë pas një shpërthimi me makinë bombë

pranë një zone diplomatike të Kabulit ku mbetën të vrarë disa njerëz duke përfshirë sulmuesit, ndërsa një shpërthim tjetër që, me sa duket, kishte në shënjestër ministrin e Mbrojtjes të Afganistanit, plagosi 10 persona. Asnjë grup militant ende nuk e ka marrë përgjegjësinë për sulmet. Situata në Afganistan është përkeqësuar pasi talibanët po e

shfrytëzojnë tërheqjen e forcave të huaja nga ky vend për të marrë më shumë territor nën kontroll. Ditët e fundit është raportuar për luftime mes talibanëve dhe forcave qeveritare në shumë rajone të vendit. Sulmet e militantëve janë përqendruar kryesisht në tre qytetet e mëdha të Herat, Lashkar Gah dhe Kandahar.

Tre të vdekur nga përplasja e trenave në Çeki

Pragë, 4 gusht - Nga një aksident hekurudhor në Çeki kanë vdekur tre persona dhe dhjetëra të tjerë janë plagosur. Aksidenti ndodhi pranë qytetit Domazlice në jugperëndim të Republikës së

Çekisë. Një tren ekspres nga Munihi i Gjermanisë për në Pragë kaloi përmes një sinjali ndalimi dhe u përplas me një tren lokal udhëtarësh, thanë autoritetet çeke.

Të vdekurit përfshinin shoferët e dy trenave dhe një pasagjer.

Tetë persona u plagosën rëndë, ndërsa pesëdhjetë të tjerë pësuan lëndime më të lehta që nuk kërkojnë trajtim

të menjëhershëm. Disa pasagjerë u dërguan me helikopterë në spitale, tha shërbimi rajonal i shpëtimit. Një hetim është duke u zhvilluar për shkaqet e aksidentit.



Qendra Wilson: Dialogu Kosovë - Serbi t'i vendosë njerëzit para territorit

PRISHTINË, 4 GUSHT - Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të riformulohet në dialog mes palëve të barabarta dhe të bazuar mbi parimin "njerëzit të parët, jo territori", thuhet në raportin e titulluar "Konsolidimi i sovranitetit të Kosovës: Pse ka rëndësi dhe çfarë duhet bërë", të Qendrës Wilson me seli në Uashington.

Sipas raportit të kësaj qendre, Kosova dhe Serbia kanë një mundësi unike që të zgjidhin një prej burimeve kryesore të tensioneve ndërshtetërore në Ballkanin Perëndimor, problemin mbi sovranitetin e Kosovës. Raporti thotë se "dykuptimësia kreative" e BE-së dhe qasja ndaj Kosovës përmes "statusit neutral" kanë arritur kufijtë e tyre. "Duke mos vepruar në mënyrë më strategjike për ta ndihmuar Kosovën dhe Serbinë që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre, BE-ja ka kontribuar në situatën aktuale, ku i gjithë rajoni është në një gjendje tensioni, duke lejuar ndërhyrjen nga Rusia, Kina dhe të tjerët", thuhet në raport, transmeton Rel.

Aty shtohet se statusi neutral rrjedh nga pesë shtetet mosnjohëse brenda BE-së, ndërkaq administrata (e presidentit amerikan, Joe) Biden duhet të fokusohet në përpjekjet që këto shtete ta ndryshojnë qasjen ndaj Kosovës. "Nëse BE-ja nuk arrin ta unifikojë pozicionin karshi Kosovës dhe ta fusë Ballkanin Perëndimor në procesin e zgjerimit, ku do t'u lejohej shteteve anëtare që të vendosin veto mbi bisedimet për anëtarësim dhe për liberalizimin e vizave për shtetet aspiruese, ndikimi i saj do të zbehët, përfshirë edhe kapacitetin e saj për ta përdorur kushtëzimin për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet, për ta luftuar korrupsionin dhe për t'i promovuar reformat", thotë raporti.

"Njerëzit para territorit"

Raporti i Qendrës Wilson rekomandon Kosovën dhe Serbinë të "vendosin njerëzit para territorit, duke bërë prioritet çështjet kyçe që prekin jetën e njerëzve". "Këtu përfshihet trajtimi i drejtësisë tranzicionale, veçanërisht zbardhja e fatit të personave të pagjetur dhe drejtësia për të mbijetuarit e dhunës seksuale si dhe mbështetja e bashkëpunimit ekonomik që lufton papunësinë". Po ashtu, Kosova dhe Serbia, sipas këtij raporti, duhet të pajtohen për reciprocitet sa iu përket të drejtave të komunitetit serb në Kosovë dhe komunitetit shqiptar në Serbi "si parim bazë që do t'i udhëhiqte marrëveshjet e ardhshme në dialogun ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë". Raporti i Qendrës Wilson vë në pah që zgjedhja e Joe Bidenit në postin e presidentit në Shtetet e Bashkuara është "inkurajuese për Kosovën".

Rekomandimet për Kosovën

Formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, sipas raportit, duhet të dizajnohet në atë mënyrë që ta mbështesë bashkëpunimin dhe t'i nxisë shkëmbimet e burimeve midis komunave. Asociacioni, shtohet në raport, duhet të formohet në bazë të Kushtetutës së Kosovës, ligjeve të BE-së dhe ligjit ndërkombëtar. "Ai (Asociacioni) nuk duhet të ketë autoritet ekzekutiv jashtë fushëveprimit të qeverisë qendrore", thekson raporti.

Më 2013, në kuadër të dialogut, Kosova dhe Serbia u pajtuan për themelimin e Asociacionit. Më 2015 palët arritën një marrëveshje për themelimin e të njëjtit, por Gjykata Kushtetuese gjeti se pika të kësaj marrëveshjeje nuk ishin në harmoni me Kushtetutën e Kosovës.

Asociacioni ishte paraparë që të krijohej me statut dhe të ketë kryetar, zëvendëskryetar, asamble dhe këshill. Ky institucion u tha se do të kishte qasje të plotë në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural dhe do të ushtronte edhe përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore.

Një tjetër rekomandim për Kosovën është nisja e një dialogu paralel, të brendshëm ndërmjet komunitetit shumicë dhe atyre joshumicë. "Ky dialog duhet të përfshijë edhe komunitetet fetare dhe duhet t'i adresojë shqetësimet e popullit të Kosovës, të cilët më parë kanë qenë të përjashtuar nga vendimmarrja", thuhet në raport. Shtohet se një Kosovë e izoluar, e copëtuar dhe jofunksionale do të vazhdonte të krijonte paqëndrueshmëri në rajon dhe më gjerë. "Dështimi për ta integruar Kosovën në organizatat dhe institucionet perëndimore shkon në dëm të interesave të Perëndimit, sigurisë dhe reputacionit. Injorimi i Kosovës është i paqëndrueshëm, duke pasur parasysh që Ballkani Perëndimor po kërcënohet gjithnjë e më shumë nga korrupsioni, kapja e shtetit nga elitat kleptokratike dhe nga ringjallja e shteteve joliberalë, autokratike, përfshirë edhe përpjekjet e Rusisë për ta frenuar integrimin euroatlantik dhe lojërave hegemoniste



ekonomike të Kinës. Mosveprimi do të thotë se humb terren", thuhet në raport.

Sfidat e Serbisë

Ngritja e një pushteti "joliberal dhe nationalist" në Serbi që udhëhiqet nga presidenti Aleksandar Vuçiq, thuhet se "përbën një rrezik të madh ndaj paqes dhe stabilitetit rajonal, njësojë sikurse raportet e ngushta të Serbisë me Rusinë dhe Kinën". Raporti thotë se qeveria serbe hapur vazhdon ta sfidojë sovranitetin e Kosovës, kërcënon kohezionin në Bosnje dhe Hercegovinë duke inkurajuar shkëputjen e Republikës Sërpska dhe bashkimit me Serbinë dhe punon që ta minojë qeverinë në Mal të Zi përmes figurave pro-serbe. Raporti i Qendrës Wilson rikujton se Serbisë i kërkohet që në bisedimet për anëtarësim në BE, t'i zgjidhë të gjitha mosmarrëveshjet ndërshtetërore dhe të jetë konform standardeve demokratike të multietnicitetit. "Është e papranueshme që BE-ja lejon Serbinë që të lëvizë përpara me procesin e anëtarësimit teksa ajo rrëshqet drejt një autokracie dhe minon një Kosovë funksionale", theksohet në raport.

Rekomandimet për BE-në dhe ShBA-në

Raporti i Qendrës Wilson thotë se në procesin e dialogut, sovraniteti dhe integriteti territorial i të dyja palëve duhet të njihet. "Ndërmjetësuesit e dialogut, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, duhet t'i mbështetnin këto principe dhe ta kundërshtojnë fuqishëm ndryshimin e kufijve", thuhet në raport. Nga BE-ja, ShBA-ja kërkohet që të mbështesë Kosovën që të anëtarësohet në organizata e institucione të ndryshme të tilla si Këshilli i Evropës, Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në BE

(OSBE), Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), INTERPOL dhe Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO).

Po ashtu, të kërkohet nga Serbia që ta ndalë fushatën kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare "dhe fushatën e saj për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës".

Gjithashtu, raporti kërkon që pesë shtetet mosnjohëse të BE-së (Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) ta ndryshojnë qasjen e tyre karshi Kosovës. "Nëse nuk e njohin Kosovën, të paktën këto shtete të mos e pengojnë Kosovën në aplikimet për anëtarësim", thekson raporti.

Në raportin "Konsolidimi i sovranitetit të Kosovës: Pse ka rëndësi dhe çfarë duhet bërë", po ashtu thuhet se BE-ja menjëherë duhet t'i liberalizojë vizat për Kosovën dhe "Franca e Holanda duhet menjëherë të heqin dorë nga kundërshtimi i tyre" lidhur me këtë çështje.

Po ashtu, raporti kërkon që të krijohet një rrugë e qartë e anëtarësimit të Kosovës në Aleancën Veri-atlantike (NATO) deri në vitin 2027.

Po ashtu, thuhet se para se Kosova t'i bashkohet NATO-s, ShBA-ja duhet të vazhdojë ta mbrojë Kosovën nga çdo kërcënim që mund të paraqesë Qeveria aktuale në Serbi, e cila "mbështetet ushtarakisht nga Rusia dhe Kina". "Nëse ka kundërshtitë të mëdha për anëtarësimin e Kosovës në NATO, ShBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe shtetet evropiane që e njohin Kosovën, duhet të angazhohen për nënshkrimin e një marrëveshjeje të sigurisë dhe mbrojtjes me Kosovën, si alternativë për anëtarësim", thuhet në raport.

Mohimi i krimeve dhe drejtësia

Sa iu përket krimeve të luftës, raporti rikujton se presidenti

serb Vuçiq dhe kryeministrja serbe Ana Brnabić vazhdojnë t'i mohojnë masakrat e kryera në Kosovë, njësojë sikurse mohojnë se në Srebrenicë ka ndodhur gjenocid. "Mohime të tilla krijojnë parakushte për paqëndrueshmëri dhe konflikte të reja", thuhet në raport.

Raporti i Qendrës Wilson thotë se nuk është bërë asnjë përparim sa i përket drejtësisë. Aty përmendet se edhe dy dekada pas përfundimit të luftës, gjykimet në Serbi janë mbajtur me vonesa të shumta dhe nuk ka pasur gjykime definitive.

Ndërkaq, sa i përket Kosovës, kjo qendër thotë se Qeveria e Kosovës duhet t'i "hetojë krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të kryera në territor para, gjatë dhe pas luftës".

Sipas raportit, që drejtësia tranzicionale të jetë efektive, kërkohet bashkëpunim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Prandaj, raporti i Qendrës Wilson kërkon që dy çështje kyçe të jenë pjesë përbërëse e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë: gjetja e të zhdukurve dhe drejtësia për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Për t'i zgjidhur çështjet e drejtësisë raporti thekson se kërkohet që të hapen arkivat për t'i gjetur 1 600 personat e zhdukur, ndërkaq për të mbijetuarit e dhunës seksuale mund të mos jetë e mundur që për të gjithë të arrihet drejtësia. Qendra Wilson është themeluar nga Kongresi amerikan më 1968 për nder të presidentit Woodrow Wilson.

Autorë kryesorë të raportit "Konsolidimi i sovranitetit të Kosovës: Pse ka rëndësi dhe çfarë duhet bërë" janë: Anna Di Lellio nga Universiteti i Nju Jorkut, Arben Hajrullahu nga Universiteti i Prishtinës, Daniel S. Hamilton, drejtor i Programit Global Europe, dhe Aidan Hehir nga Qendra Woodrow Wilson. Ky raport është mbështetur nga Eliot L. Engel, Sonja Biserko, Edward P. Joseph, Daniel Serwer e të tjerët.



NUMRI DITOR I RASTEVE TË INFEKTIMIT ME COVID-19 NË KOSOVË NË MUAJIN GUSHT KA PREKUR SHIFRAT TRESHIFRORE

Dyfishohen rastet me Covid në Kosovë

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 221 infektive të reja me Covid-19, ndërsa një person ka vdekur. Një ditë më parë ishin raportuar 110 raste pozitive. Në total numri i rasteve aktive është 888. Ministria e Shëndetësisë ka treguar se në 24 orët e fundit janë dhënë 14 616 doza të vaksinës, ndërsa 162 807 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë të vaksinës. Numri i rasteve ka filluar të rritet në pjesën e dytë të muajit korrik, kur janë liruar pothuajse të gjitha masat kundër Covidit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 GUSHT - Kosova ka shënuar të mërkurën dyfishim të rasteve të infektimit me Covid-19. Ministria e Shëndetësisë, duke iu referuar raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), ka bërë me dije se nga 3 160 testime, 221 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë kësaj periudhe kohore është raportuar për një rast të vdekjes nga Covidi. “Nga 3 160 testime, 221 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Sot janë shëruar 21 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 688. Në total numri i rasteve aktive është 888”, është thënë në njoftimin e Ministrisë

së Shëndetësisë.

Në mesin e personave deri në 19 vjeç janë regjistruar 24 raste pozitive me Covid, ndërsa në grupmoshën prej 20 deri në 39 vjeç janë regjistruar 105 raste pozitive.

Shifrat e infektimit janë shumë më të larta sesa kanë qenë një ditë më parë.

Nga 3 667 testime që ishin bërë të martën, 110 qytetarë kishin rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Numri i rasteve ka filluar të rritet në pjesën e dytë të muajit korrik, kur janë liruar pothuajse të gjitha masat kundër Covidit.

Derisa në pjesën e parë të muajit korrik numri ditor i rasteve të infektimit ishte njëshifror, në pjesën e dytë të muajit rastet kishin filluar të dyfishohen.

Më 17 korrik në total numri i rasteve aktive në Kosovë kishte

rënë nën 100, kurse tani numri total i rasteve aktive është 888.

Mbi 14 mijë doza të vaksinës administrohen në 24 orët e fundit

Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se interesimi i qytetarëve për ta marrë vaksinën është rritur kohën e fundit. Kjo ministri ka treguar se vetëm në 24 orët e fundit janë dhënë 14 616 doza të vaksinës kundër Covidit. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 14 616 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 460 297 doza të vaksinës. Deri më sot 162 807 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë”, është theksuar në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Rritjen e interesimit për

vaksinim të qytetarëve e ka konfirmuar edhe zëdhënësi i Ministrisë së Shëndetësisë, Faik Hoti. Ai ka deklaruar se tani autoritetet shtetërore kanë krijuar mundësi të mira për vaksinim për të gjithë qytetarët. “Duke qenë që Ministria e Shëndetësisë ka hequr çdo kufizim të moshës për vaksinim të qytetarëve me vaksinën dhe u ka mundësuar të gjithë qytetarëve mbi moshën 18 vjet që të vaksinohen, interesimi i vaksinimit kundër Covid-19 është rritur ndjeshëm. Këtyre ditëve shohim interesim të madh të qytetarëve për t’u vaksinuar dhe ajo që është me interes është se shohim se po vaksinohen grupmoshat e reja dhe ky është një sinjal i mirë”, ka thënë Hoti për mediat. Ai ka treguar edhe për qindjen e qytetarëve të vaksinuar deri më tani. “Ne mund të themi se me dozën e parë janë vaksinuar rreth 25 për qind e popullatës, me dozën e dytë përqindja shkon në 13 deri në 14 për qind. Këto përqindje duhet t’i ngrehim në ditët në vijim”, ka deklaruar Hoti. Ditë më parë, para deputetëve, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka

bërë me dije se deri në fund të vitit do të arrihet objektivi që të vaksinohet rreth 60 për qind e popullatës. “Përkundër sfidave që i kemi, interesimi i qytetarëve çdo ditë e më shumë për vaksinim po rritet dhe ne qëndrojmë në objektivin tonë për vaksinim deri në fund të vitit që 60 për qind e popullatës duhet të përfshihet në vaksinim. Varianti ‘Delta’ është i pranishëm mbi 80 për qind të të infektuarve ditor dhe ky variant është jashtëzakonisht i rrezikshëm dhe e vetmja alternativë është vaksinimi”, ka thënë Vitia.

Prej 13 marsit të vitit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 108 844 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 268 kanë vdekur. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë ka bërë me dije se rreth 90 për qind të rasteve të infektimit me koronavirus në Kosovë janë të lidhura me variantin “Delta” të këtij virusi. Sipas këtij instituti, varianti “Delta” është dominues edhe në Kosovë.

Haxhiu: Përgjimet e lansuara ditët e fundit, tronditëse për sistemin e drejtësisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 GUSHT - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në një konferencë për media mbajtur të mërkurën, pas publikimit të disa audioincizimeve që kanë të bëjnë me sektorin e drejtësisë, saktësisht në prokurori, ka thënë: "Gjatë këtyre ditëve kemi përcjellë me shumë vëmendje publikimet nga përgjimet e lansuara në medime dhe rrjete sociale, të cilat janë tronditëse për sistemin e drejtësisë, përkatësisht sistemin prokurorial dhe gjyqësor. Të vetëdijshëm që për shumë vjet zyrtarë të ndryshëm në institucionet më të larta të drejtësisë, kanë abuzuar me detyrën, rolin dhe përgjegjësitë e

tyre, jemi angazhuar paseshtur që përmes mekanizmave institucionale shtetërore, si qeverisje e re, me besimin e plotë qytetarë, të vihemi në shërbim të drejtësisë, t'i ndërmarrim hapat e duhur e legjitimë, për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Të gjitha këto çdoherë përbrenda kompetencave të ministrisë, duke filluar nga majat e institucioneve për t'i çliruar ato dhe për të sjellë rregull, drejtësi dhe dinjitet", ka thënë Haxhiu. Ajo ka theksuar se "kambanat kundrejt cenimit të drejtësisë po bien sërish disa vjet pas publikimit të asaj që njihet si 'Pronto Afera'", ku shpërfaqej abuzimi i pushtetarëve me detyrën dhe besimin e rolit institucional".

Haxhiu ka thënë se ndër

prioritetet të cilat do të vënë në lëvizje drejtimin e duhur është vetingu, i cili, sipas saj, është shtyllë përcaktuese për të sjellë drejtësi në vend. "Si mekanizëm ligjor për të luftuar këtë fenomen, prioriteti i Ministrisë së Drejtësisë mbetet vetingu. Për këtë tashmë jemi në rrugë të mbarë", ka thënë ajo.

Ministria Haxhiu ka treguar se është hartuar koncept-dokumenti për vetingun i cili në fund të gushtit do të shkojë për aprovim në kabinetin qeveritar, i cili proces, sipas saj, është hap i domosdoshëm për të progresuar drejt funksionalizimit dhe jetësimit të tij gradual, me të vetmin qëllim: vlerësimin në integritetin profesional, moral si dhe krijimin e besimit në institucione të vendit. "Jemi duke e parë me sytë tanë cenimin e

integritetit të institucioneve të drejtësisë, me ç'rast nuk mund të rrimë pa vepruar. Kjo situatë e patolerueshme dhe publikimet e incizimeve të tilla na dëshmojnë se nuk është i përfshirë vetëm i shkarkuari i djeshëm, drejtori i Njësisë për Inteljencë Financiare. Të përfshirë në këtë aferë janë edhe gjykatës e prokurorë, nga strukturat më të larta të organeve të drejtësisë", ka deklaruar ajo.

Haxhiu ka thënë se institucionet brenda sistemit të drejtësisë të cilat janë të thirrura për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, fatkeqësisht janë shkelur nga ta. "Kjo është e patolerueshme, e pandershme dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe praktikën e mira të zbatimit të ligjeve në fuqi. Nga këtu,

publikisht, duke qenë e vetëdijshme edhe për ndarjen e pushteteve, si ministre e Drejtësisë, u bëj thirrje Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, që urgjentisht t'i ndërmarrin masat adekuate, përbrenda kompetencave, në mënyrë që të hetohen dhe trajtohen rastet të cilat sfidojnë dhe cenojnë seriozisht integritetin institucional të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Qëndrimi im nuk mund të jetë indiferent, prandaj zotohem që përbrenda kompetencave të mia si ministre, do të angazhohem, krahas të gjithë atyre vullneteve të palëkundura për të sjellë drejtësi, rend dhe ligj të zbatueshëm në vend, për të gjithë, pa dallim", ka thënë ministria Haxhiu.

Gjendja me zjarre në Malishevë, e qetë

MALISHEVË, 4 GUSHT (ER) - Situata me zjarre në territorin e komunës së Malishevës është e qetë dhe në kontroll të plotë, përderisa edhe zjarret e dy ditëve më parë janë lokalizuar, por në të njëjtën kohë u bëhet thirrje qytetarëve që të bëjnë kujdes

të shtuar dhe të mos ndezin hamulloret. Kështu është thënë të mërkurën në një takim të përbashkët të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Njësisë së Zjarrfikësve dhe Shpëtimit dhe Policisë së Kosovës. Këtë takim të cilin e ka drejtuar

drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Hafir Rexha, është diskutuar situata aktuale me zjarre, kjo pasi më 2 gusht, në territorin e komunës së Malishevës, janë shkaktuar disa zjarre, dy prej të cilave me përmasa të mëdha.



Bulliçi kërkon mbështetje shtesë nga qeveria për projektet në Podujevë

PODUJEVË, 4 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliçi, ka pritur të mërkurën në takim ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, të cilin e ka informuar për projektet që po realizohen në komunën e Podujevës dhe planifikimet për të ardhmen.

Në takim, ku ishte i pranishëm edhe deputeti llapjan Fitim Haziri, drejtori i Urbanizmit, Bujar Hasani dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Fevzi



Jetullahu, kryetari Bulliçi ka kërkuar mbështetje shtesë nga qeveria për projektet e komunës së Podujevës. "Komuna e Podujevës bën pjesë në komunat e mëdha si për nga territori, po ashtu edhe për nga numri i popullsisë, ndaj edhe nevojat dhe kërkesat për investime janë të mëdha, ndaj presim dhe kërkojmë mbështetjen e nivelit qendror", ka thënë Bulliçi.

Ndërsa ministri Krasniqi u zotua për angazhim në mbështetje të projekteve të

përbashkëta me komunën e Podujevës. Pas takimit, delegacioni i komunës së Podujevës, së bashku me ministrin Krasniqi, vizituan lagjet ku jetojnë qytetarët e komuniteteve pakicë, për t'i parë nga afër kushtet në të cilat ata jetojnë, nevojat dhe kërkesat e tyre.

Kryetari Bulliçi dhe ministri Krasniqi u zotuan se do të punojnë maksimalisht që do të ofrojnë përkrahje dhe ndihmë bazuar në nevojat që kanë këto komunitete.

Asfaltohet rruga në fshatin Nekoc pasi komuna obligoi kompaninë për riparimin e dëmeve

Drenas, 4 gusht (ER) - Fundvitin e kaluar ishte asfaltuar rruga me gjatësi prej 600 metrash në fshatin Nekoc të Drenasit, por për shkak të cilësisë së dobët të punimeve ishte dëmtuar asfalti dhe menjëherë pas marrjes së informacioneve nga banorët e fshatit, kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, në konsultim me ekspertët e Drejtorisë së

Infrastrukturës, kanë marrë të gjitha masat për sanimin e këtij dëmi. "Kompania ishte urdhëruar t'i marrë përsipër të gjitha dëmet, të sanojë në afatin sa më të shkurtër dhe sot kompania ka bërë sanimin e dëmeve dhe ka bërë asfaltimin e ri të kësaj rruge", ka njoftuar komuna e Drenasit.

Sipas këtij njoftimi, kryetari

Lladrovci ka falënderuar banorët e fshatit Nekoc për bashkëpunimin dhe u ka kërkuar falje për vonesat e realizimit të këtij projekti, që janë krijuar si pasojë e papërgjegjësisë të kompanisë së kontraktuar. "Lladrovci u bën thirrje të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë nënshkruar kontrata me komunën, që t'u

përmbahen kontratave të nënshkruara, ndryshe nuk do të ketë asnjë kompromis për asnjë punë që nuk kryhet në përputhje me kontratën. Komuna e Drenasit zotohet se do ta vazhdojë punën meritore për qytetarët dhe duke u respektuar sipas kontratave të nënshkruara", ka njoftuar komuna e Drenasit.



Kryetari Jashari bën homazhe në nderim të dëshmorit Fekë Durmishi

SKENDERAJ, 4 GUSHT (ER) - Të mërkurën janë bërë 23 vjet nga rënia heroike e dëshmorit Fekë Durmishi nga fshati Rakinicë, i cili ra në mbrojtje

të vendit, për t'u bërë pjesë e historisë sonë të lavdishme. Kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, bashkë me shoqatat e dala

nga lufta e UÇK-së, nënkryetarin Nuredin Lushtaku, drejtorë, asamblistë e familjarë të dëshmorit, kanë bërë homazhe te varri i tij në

Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në Marinë. Me këtë rast, kryetari Jashari ka thënë se e kanë obligim moral e institucional që të bashkuar

të punojnë për jetësimin e amanetit të të rënëve, për të pasur mirëqenie për të gjithë.



Ismaili kërkon që të ndalohet finalizimi i planit zhvillimor për Prishtinën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 GUSHT - Kandidati për kryetar të Prishtinës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Uran Ismaili, ka reaguar në lidhje me vendimin e komunës së Prishtinës për ta proceduar votimin e planit zhvillimor të qytetit për tetë vjetet e ardhshëm. "Prishtina që e kemi sot dhe ndërtimet e egra 'me leje' janë rezultat i Planit Zhvillimor Komunal të miratuar në vitin 2013, disa muaj para zgjedhjeve. E njëjta po tentohet të bëhet tani: votimi i Planit Zhvillimor Komunal vetëm dy muaj para zgjedhjeve. Kjo nuk mund të bëhet pa i përfshirë qytetarët e Prishtinës. Kjo nuk mund të bëhet tani. Plani për Prishtinën është dokument që përcakton zhvillimin e qytetit për tetë vjetet

e ardhshëm. Ky dokument përcakton ndërtimin e çerdheve, rrugëve, ambulancave, parqeve e ndërtesave të mëdha për banim, në fakt në qendër të diskutimit janë tokat, ndërtuesit, grupet e interesit dhe pazaret për koeficiente pronash. Është e papranueshme që kjo të bëhet pa diskutim të gjatë, gjithëpërfshirës e të mirëfilltë publikë", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai i ka bërë thirrje administratës së tashme të komunës së Prishtinës që të adalojë finalizimin e PZHK-së. "Të gjithë kandidatët për kryetar të Prishtinës që të marrin qëndrim kundër miratimit të Planit Zhvillimor dy muaj para zgjedhjeve. Ftoj të gjithë asamblistët që të mos e aprovojnë një plan kaq të rëndësishëm dy muaj para zgjedhjeve. Kjo kërkesë



e imja duhet të jetë kërkesë e secilit prej nesh që ia duam të mirën Prishtinës. Planet për të

ardhmen duhet të bëhen nga qeverisja e ardhshme që do të zgjidhet nga qytetarët, e jo nga

qeverisja që shkon", ka thënë kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili.

Mbahet dëgjimi publik mbi nismën legislative "Projektligji për kriptovaluta"

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 4 GUSHT - Grupi punues i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, i kryesuar nga Mimoza Kusari-Lila, ka mbajtur të mërkurën dëgjim publik mbi nismën legislative "Projektligji për kriptovaluta". Në këtë dëgjim publik pjesëmarrës ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave, Punës

dhe Transfereve, përfaqësues nga Bankës Qendrore e Kosovës, të Këshillit Investitor Evropian, si dhe shumë palë të tjera të interesit, të cilët shpalesën idetë dhe njohuritë e tyre mbi kriptovalutat.

Në mbledhje kishte diversitet mendimesh mbi mënyrën e funksionimit të kriptovalutave, duke u bazuar në përvojat e tyre personale, gjë e cila ishte mjaft e rëndësishme për grupin punues

të kësaj nisme legislative.


Kjo mbledhje u përmyll me kërkesën e kryesueses së grupit punues për palët e interesit, që të gjitha informatat të cilat ata i kanë e që lidhen me konceptin e kriptovalutave, t'i dërgojnë në adresë të Komisionit për Ekonomi, Industri dhe Tregti, në mënyrë që të analizohen në përpikëri dhe t'i hapet rrugë avancimit të kësaj nisme legislative.

Osmani dekreton Ligjin për Automjete dhe Marrëveshjen Financiare për IPA 2020

PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Në përputhje me kompetencat kushtetuese, presidentja Vjosa Osmani ka dekreton shpalljen e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Automjete. "Përmes dekretit nr. 113/2021 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, i miratuar nga

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22.07.2021 dhe i pranuar nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, më 02.08.2021. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, përfundimisht i vjen fundi edhe procesit të homologimit të veturave të importuara në Republikën e Kosovës", është bërë me dije në njoftimin e Presidentes. Po ashtu, presidentja Osmani ka

dekreton edhe shpalljen e Ligjit nr. 08/L-014 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22.07.2021 dhe i pranuar nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, më 02.08.2021.



Mbingarkohet Klinika e Pediatriisë, për një javë u trajtuan 1 163 fëmijë



PRISHTINË, 4 GUSHT (ER) - Klinika e Pediatriisë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është mbingarkuar me fëmijë që po kërkojnë trajtim ambulator dhe spitalor. Sipas raportit javor të kësaj

klinike, për një javë janë trajtuar 1 163 fëmijë. Nga numri i përgjithshëm i rasteve, 785 kanë qenë vizita në kuadër të Emergjencës Pediatrike, kurse 378 vizita në Ambulancat specialiste. Brenda javës për trajtim

spitalor janë pranuar 206 fëmijë.

Gjatë muajit korrik Klinika e Pediatriisë ka trajtuar 3 712 raste, përfshirë 2 409 vizita në Emergjencën Pediatrike, 1 303 vizita në ambulancat specialiste.

Kuvendi i Kosovës për gjashtë muaj shpenzoi mbi 3 milionë euro

Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka paraqitur të mërkurën para anëtarëve të Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere raportin rreth shpenzimeve për gjashtëmujorin e vitit 2021 të Kuvendit të Kosovës. “Rreth 3 milionë euro ka qenë buxheti i shpenzuar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti”, ka thënë Krasniqi. Pas diskutimeve, raporti u përkrah njëzëri nga anëtarët e komisionit dhe i njëjti dërgohet në kryesinë e Kuvendit për miratim.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 GUSHT - Kuvendi i Kosovës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 ka shpenzuar mbi 3 milionë euro, është bërë me dije të mërkurën në mbledhjen e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, ku është miratuar raporti i shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka thënë se për paga dhe mëditje janë shpenzuar 100 për qind e mjeteve, ndërsa për mallra dhe shpenzime 37 për qind e mjeteve. “Rreth 3 milionë euro ka qenë buxheti i shpenzuar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti”, ka thënë Krasniqi.

Nënkryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Mërgim Lushtaku, ka thënë se pajtohet me raportin që ka

paraqitur sekretari dhe nuk ka diçka për të shtuar. Ndërkaq deputeti i LV-së, Visar Korenica, ka kërkuar detaje për një avanc rreth 5 000.00 euro.

Në lidhje me këtë, Ismet Krasniqi ka thënë se këto mjete janë ndarë për udhëtime jashtë vendit të disa deputetëve. Pas diskutimeve, raporti u përkrah njëzëri nga anëtarët e komisionit dhe i njëjti dërgohet në kryesinë e Kuvendit për miratim.

Në këtë mbledhje u shqyrtua edhe raporti i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2020, të cilin e prezantoi drejtori Nazim Rrahimi. Pas prezantimit, u hap debati, me ç’rast deputetët shtruan pyetje për çështje të ndryshme të cilat morën përgjigje nga drejtori i ARKEP-it. Raporti i ARKEP u hodh në votim, por i njëjti nuk mori mbështetjen e Komisionit.



Në vazhdim të mbledhjes u shqyrtua Projektligji për ratifikimin e Amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes të lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze në lidhje me Programin Kornizë për bashkëpunim financiar. Ministri i Financave, Hekuran Murati, duke paraqitur këtë projektligj, ka thënë se bëhet fjalë për një kredi prej 62 milionë eurosh nga qeveria hungareze, si vazhdimësi e marrëveshjes së

nënshkruar në vitin 2016. Ky projektligj mori votat e shumicës së anëtarëve të Komisionit.

Komisioni miratoi edhe tri kërkesa për hulumtime parlamentare si dhe mbështeti Projektligjin nr. 08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere nuk miratoi raportin vjetor financiar të

Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2020, raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2020, raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit për vitin 2020, raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, si dhe raportin vjetor financiar të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Komisioni për Ekonomi miraton emrat për bordin e ri të AKP-së

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 GUSHT - Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, e cila është kryesuar nga kryetari Ferat Shala. Në këtë mbledhje u shqyrtua propozim-vendimi i qeverisë për emërimin e bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Anëtarët e propozuar nga ana e qeverisë janë: Nazmi Mikollovci, kryesues, Syzana Dautaj-Surdullli, Mentor Hyseni, Vjollca Jashari, Violeta Arifi-Krasniqi, Xhevdet Neziraj, Halim Muçolli dhe Avni Ajdini.

Pas diskutimeve, komisioni, me 6 vota për, 3 kundër dhe asnjë abstenim, i dha mbështetje propozim-vendimit të qeverisë, duke i rekomanduar seancës miratimin e tij. Kjo mbledhje u karakterizua me akuza mes pozitës dhe opozitës.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Ferat Shala, ka

theksuar se është pro emërimit të këtij bordi, por ka thënë se kryesuesi i këtij bordi, Nazmi Mikollovci, ka konflikt interesi. “Kandidati i propozuar ka punuar shtatë vjet të plota në ndërmarrjen ‘Trepça’. Në periudhën kur ‘Trepça’ është dëmtuar shumë”, ka thënë Shala.

Deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka pyetur se sa ka afat ky bord. “Këtu nuk po shoh se ka një mandat që do të shkohet për dy vjet apo më gjatë. Kjo po shihet se është politike. A është bord për shuarjen e AKP-së? Unë nuk pajtohem derisa nuk e dimë se sa do të zgjasë shuarja e AKP-së. Shuarja duhet të fillojë me plotësim-ndryshimin e ligjit. Pra, kam dëshirë të di se sa është mandati i tyre”, ka deklaruar Lekaj.

Deputetja e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se qeveria nuk e ka mandatin ta caktojë se sa do të zgjasë shuarja e AKP-së. “Jam e bindur se ky bord do të jetë i fundit në AKP. Përgatitja e anëtarëve është ndoshta më e




mira që kemi pasur deri më tani. Ky bord do ta bëjë transformimin e politikave. Për herë të parë janë tri gra të cilat janë propozuar për

bordin e AKP-së. Është treni i fundit për të shpëtuar asetet”, ka thënë Kusari-Lila. Kurse deputetja e LDK-së,

Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se është dashur të sillej plotësim-ndryshimi i ligjit dhe jo emrat puropolitikë për bordin.

FIorentINI



NGA: ITALO CALVINO
PËRKTHEU: KUJTIM ABDI

NA ISHTE NJËHERË NJË FIORENTIN QË ÇDO MBRËMJE MERRTE PJESË NË BISEDA DHE DËGJONTE NJERËZIT TË TREGONIN PËR UDHËTIMET E TYRE NË VENDE TË NDRYSHME TË BOTËS. AI S'KISHTE ASGJË TË TREGONTE PËR VETEN, MBASI GJITHË JETËS KISHTE JETUAR NË FIRENCE DHE PRANDAJ I DUKEJ VETJA SI GUAK.

KËSHTU, I HIPI NË KOKË TË UDHËTONTE; S'GJETI REHAT DERISA I SHITI TË GJITHA, PËRGATITI BAGAZHET DHE U NIS. EC E EC, DERI NË MES TË NATËS, KUR TROKITI NË DERËN E NJË FAMULLITARI PËR TË KALUAR NATËN. FAMULLITARI I SHITOI PËR TË NGRËNË DHE NDËRSA HANTE E PYETI SE PËR KU SHKONTE. KUR DËGJOI SE FIORENTINI KISH MARRË RRUGËT PËR TË PASUR DIÇKA TË TREGONTE DHE AI NË FIRENCE, THA:

– EDHE MUA MË KA LINDUR SHPESH KJO DËSHIRË, DHE MEQË ËSHTË RASTI, NËSE S'TË VJEN KEQ, VAZHDOJMË BASHKË.

– ME GJITHË QEFË – U PËRGJIGJ FIORENTINI. – AS MË SHKONTE NDËRMEND SE DO TË PËLQENTE.

E, NË TË AGUAR U NISËN SË BASHKU, FIORENTINI DHE FAMULLITARI.

NATA I ZURI PRANË NJË HANI. KËRKUAN TË STREHOHESHIN DHE HANXHIU I PYETI:

– PËR KU UDHËTONI?

PASI MËSOI QËLLIMIN E TYRE I LINDI DHE ATIJ DËSHIRA TË SHKONTE ME TA, E KËSHTU NË AGIM U NISËN SË BASHKU.

PËRSHKUAN MJAFT RRUGË, GJERSA MË SË FUNDI ARRITËN NË PALLATIN E NJË GJIGANTIT.

– TROKASIM – THA FIORENTINI – KËSHTU KUR TË KTHEHEMI NË SHTËPI KEMI TË TREGOJMË PËR NJË GJIGANT.

GJIGANTI HAPI DERËN DHE I FTOI BRENDA.

– PO TË DONI JETOJMË BASHKË – THA MË PAS AI – PËR KISHËZËN MË MUNGON FAMULLITARI, PËR HANIN HANXHIU, DHE PËR FIORENTININ, NDONËSE PËR TË S'KAM NEVOJË, PO DO T'I GJEJMË NJË VEND EDHE ATIJ.

TË TRE THANË NJËZËRI:

– MREKULLI! TË JESH NË SHËRBIM TË NJË GJIGANTIT NATYRISHT QË DO TË SHOHËSH GJËRA TË ÇUDITSHME, E KUSH E MERR ME MEND Ç'DO TË KEMI TË TREGOJMË MË PAS! – DHE PRANUAN.

I SHPURI TË FLENË DHE GATI TËRË NATËS MENDOI SE Ç'DO T'I KURDISTE TË NESËRMEN.

QË PA GDHIRË MIRË, GJIGANTI I THA FAMULLITARIT:

– HAJDE ME MUA TË T'TREGOJ LIBRAT – DHE E FUTI NË NJË DHOMË.

FIORENTINI QË ISHTE MJAFT KURIOZ DHE S'DONTE TË HUMBTE RASTIN PËR TË PARË NDONJË GJË INTERESANTE, VURI SYRIN TEK VRIMA E ÇELËSIT DHE

PA SE NDËRSA FAMULLITARI U PËRKUL TË SHIHE LIBRAT, GJIGANTI NGRITTI SHPATËN DHE I PREU KOKËN DHE E FUTI NË NJË VOZË.

– KJO PO, VLEN TË TREGOHET NË FIRENCE! – MENDOI FIORENTINI. – E KEQJA DO TË JETË SE S'DO TË MË BESOJNË!

FAMULLITARIT IA SQAROVA PUNËN – JU DREJTUA GJIGANTI – TANI HAJDE TË TREGOJ HANIN E Ç'DO TË BËSH.

DHE HANXHIU PA JA BËRË DYSH E NDOQI GJIGANTIN DREJT NJË DHOMË.

FIORENTINI NGA VRIMA E ÇELËSIT PA SE SI SHPATA E GJIGANTIT NDAU TRUPIN NGA KOKA E HANXHIUT, E TË PËRFUNDONTE DHE AI NË NJË VOZË.

POTHUAJ SE NDJEHEJ I LUMTUR PËR SA GJËRA TË ÇUDITSHME KISHTE TË TREGONTE KUR TË KTHEHEJ, E U TRISHTUA NË ÇAST KUR MENDOI SE MBAS FAMULLITARIT DHE HANXHIUT I VINTE RADHA ATIJ, E KËSHTU S'DO TË MUND TË TREGONTE ASGJË. MENDOI SE MË MIRË ISHTE TË IKTE, POR SAKAQ GJIGANTI DOLI NGA DHOMA DHE I THA PARA SE T'I CAKTONTE DHE ATIJ PUNËN, DONTE TË DREKOSEJ. U ULËN NË TAVOLINË, POR FIORENTINI S'QE E MUNDUR TË GËLLTISTE QOFTË DHE NJË KAFSHATË, POR VETËM MENDONTE SE SI TË SHPËTONTE NGA KTHETRAT E GJIGANTIT.

GJIGANTI KISHTE NJË SY TË SHTREMBËR. NË TË MBARUAR TË DREKËS FIORENTINI FILLOI T'I THOTË:

– GJYNAH! TË JE MJAFT I PASHËM, POR

VEÇSE KY SYRI ...

GJIGANTI QË PËR HERË TË PARË DËGJONTE DIKË T'I FLISTE PËR SYRIN E TIJ, U VU NË SIKLET, S'E ZINTE VENDI, PËRPLASTE QERPIKËT DHE SHTREMBËRONTE VETULLAT.

– E DI? – VAZHDOI FIORENTINI – NJOH NJË BARISHTE QË PËR SYTË E SHTREMBËR ËSHTË NJË MREKULLI, DHE MË DUKET SE E KAM PARË KËTU NË KOPSHTIN TËND.

– VËRTET? – U HODH PËRNJËHERËSH GJIGANTI. – E KE PARË NË KOPSHTIN TIM? E ATËHERË Ç'PRET? HAJDE TA GJEJMË!

DHE, DOLËN PËR NË KOPSHT, E DUKE DALË FIORENTINI PA ME VËMENDJE PORTAT DHE BRAVAT, QË T'I KISHTE TË QARTA NË KOKË KUR T'IA MBATHTE. NË KOPSHT KËPUTI NJË BIMË ÇFARËDO: KUR U FUTËN BRENDA E VURI TË ZIEJ NË NJË ENË ME VAJ.

– PO TË THEM QË PËRPARA SE DO TË DHËMBI PAK, – I THA GJIGANTIT. – A JE I ZOTI TA DUROSH DHIMBJEN PA LËVIZUR?

– AS DISKUTOHET! – JU PËRGJIGJ AI.

– THEM SE ËSHTË MË MIRË TË TË LIDH MBAS KËSAJ TAVOLINE TË MERMERTË, SEPSE NËSE LËVIZ SADO PAK, OPERACIONI DËSHTON.

GJIGANTI QË DONTE ME ÇDO KUSHT TA DREJTONTE SYRIN PRANOI ME KËNAQËSI TË LIDHEJ MBAS TAVOLINËS SË MERMERTË. KUR E LIDHI MIRË SI NJË SALLAM, FIORENTINI IA ZBRAZI

TENXHEREN ME VAJ TË PËRVËLUAR NË TË DY SYTË DUKE E QORRUAR KREJT DHE IA DHA VRAPIT NËPËR SHKALLË DUKE MENDUAR: “KJO PO, ËSHTË PËR TË TREGUAR!”


GJIGANTI ME NJË ULËRIMË SA BËRI TË DRIDHET TOKA U NGRIT ME GJITHË TAVOLINËN MBI SHPATULLA DHE IU VU PAS. POR, DUKE E KUPTUAR SE KËSHTU I VERBËR QE E KOTË TA NDIQTE, MENDOI TË PËRDORTE DREDHINË:

– FIORENTINI! – I THIRRI. – PSE S'MA MBARON KURËN? SA DO TË TË JAP? VETËM MË SHËRO! JA KËTË UNAZË! – TË CILËN SAPO E HOQI NGA GISHTI. ISHTE NJË UNAZË E MAGJEPSUR.

– MA JEP! – THA FIORENTINI, – KËTË DO TA ÇOJ NË FIRENCE DHE DO T'IA TREGOJ KUJTDI QË S'DO T'MË BESOJË!

POR ME TA MARRË E TA VËNË NË GISHT, JA QË GISHTI IU KTHYE NË MERMER, I RËNDË SA QË I DUHEJ TA TËRHIQTE DORËN ZVARRË, E MEZI HIQJ PËRPARA. AQ SA MBAS PAK S'MUND TË VAZHDONTE MË, MBASI S'IA DILTE TË NGRINTE PESHËN E KRAHUT. U MUNDUA TA HEQË UNAZËN PREJ GISHTIT, POR S'ARRITI DOT. GJIGANTI GATI PO E ZINTE. NË KULM TË DËSHPËRIMIT, FIORENTINI NXORI NGA XHEPI NJË THIKË DHE E PREU GISHTIN. VETËM KËSHTU MUNDI TË SHPËTOJË DHE T'I ZHDUKET GJIGANTIT.

ARRITI NË FIRENCE ME GJUHËN QË I VAREJ JASHTË DHE I KISHTE IKUR ÇDO DËSHIRË JO VETËM PËR TË PARË BOTËN, POR DHE PËR TË TREGUAR QOFTË DHE PËR NJË GJË! PËR GISHTIN THA SE E KISHTE PRERË DUKE KORRUR BAR.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Shosholli: Formimi i Ligës U21 është domosdoshmëri

“Pas konsultimeve të vazhdueshme me presidentin Ademi, kemi ardhur në përfundim se formimi i ligës për grupmoshën 21 vjeç është domosdoshmëri. Po e shohim se shumë futbollistë pas përfundimit të kohës si lojtarë të ekipeve U19 nuk po arrijnë të gjejnë vend në ekipet e para”, ka thënë Ajet Shosholli



PRISHTINË, 4 GUSHT - Futbollit të Kosovës së shpejti mund t'i shtohet një tjetër nivel i garave. Bëhet fjalë për Ligën U21, propozim i cili tashmë është zyrtarizuar nga këshilltari profesional i FFK-së, Ajet Shosholli, në koordinim me bordin e Shoqatës së Trajnerëve dhe kryetarin e saj, Muharrem Sahiti. Ky propozim tashmë i është paraqitur Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, organ i cili do ta shqyrtojë së shpejti për t'i dhënë drejtim kësaj ideje.

Trajneri i mirënjohur Ajet Shosholli, për faqen zyrtare të FFK-së, e ka sqaruar propozimin e tij, duke thënë se formimi i kësaj lige është i domosdoshëm, duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat po ballafaqohen lojtarët e rinj, të cilët, pas skadimit të mundësisë për të luajtur në ekipet U19, po gjenden në situatë të palakmueshme dhe shumë

prej tyre edhe po heqin dorë nga vazhdimi i karrierës si futbollistë. “Pas konsultimeve të vazhdueshme me presidentin Ademi, kemi ardhur në përfundim se formimi i ligës për grupmoshën 21 vjeç është domosdoshmëri. Po e shohim se shumë futbollistë pas përfundimit të kohës si lojtarë të ekipeve U19, nuk po arrijnë të gjejnë vend në ekipet e para. Në të shumtën e rasteve vetëm nga dy apo tre lojtarë arrijnë t'u bashkohen ekipeve të para, derisa lojtarët e tjerë ndodhen në situatë të vështirë. Për këtë arsye, ne e shohim të domosdoshme krijimin e Ligës U21, e cila do t'ua mundësonte këtyre lojtarëve vazhdimësinë e punës dhe garave. Ky është një lloj modeli të cilin e praktikojnë edhe vendet e tjera evropiane të cilat garojnë me ekipet B. Kjo ligë do t'ua jepte mundësinë lojtarëve që ta rritin formën e tyre,

teksta në të do të mund të përfshihen edhe dy-tre lojtarë nga ekipet e para, të cilët kanë mungesë të ndeshjeve apo për një kohë kanë qenë të lënduar. Pra, si ligë do të kishte shumë përfitime edhe për vetë klubet. Normalisht se pjesëmarrja në një ligë të tillë nuk do të jetë obliguese, por rekomandohet për ato klube që i kanë kushtet më të mira dhe që kanë numër të madh të lojtarëve, e të cilët e kanë të vështirë të gjejnë vend në ekipin e parë”, ka thënë Shosholli.

Në futbollin e Kosovës, krahas garave të ekipeve të sendorëve, organizohen gara në nivel kombëtar edhe në grupmoshat nën 17 vjeç dhe nën 19 vjeç në konkurrencën e meshkujve, si dhe garat nën 17 vjeç në konkurrencën e femrave, derisa në regjione organizohen garat në të gjitha grupmoshat më të ulëta.

SHKURT

Luiza Gega renditet e 13-ta në Lojërat Olimpike

Përfundon garimi i Luiza Gegës në Lojërat Olimpike të Tokios. Atletja shqiptare mori pjesë sot në garën e 3 000 metrave me pengesa. 32-vjeçarja u rendit në vendin e 13-të nga 15 pjesëmarrës, teksa regjistroi kohën (9:34.10), 11 sekonda më shumë se pak ditë më parë kur u kualifikua në finale. Medaljen e artë e fitoi Peruth Chemutai, atletja nga Uganda. 22-vjeçarja afrikane regjistroi kohën (9:01.45) dhe i dhuroi vendit të saj medaljen e artë. Në podium u ngjitën edhe Courtney Frerichs nga ShBA (medalje argjendi) dhe Hyvin Kiyeng nga Kenia (medalje e bronzit).

Osmani përforcon Vushtrinë

Mbrojtësi i njohur në futbollin e Kosovës, Përparim Osmani, ka nënshkruar marrëveshje me skuadrën e Vushtrisë. Futbollisti i njohur me nofkën “Laçi” ka qenë pjesë e shumë klubeve në Kosovë, përfshirë edhe Prishtinën. “Përparim Osmani nënshkruan me Vushtrinë. Mbrojtësi i krahut me tipare ofensive, i lindur në Prishtinë (33 vjeç), me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, ish-anëtar i shumë klubeve si KF Ferronikeli, FC Drita, FC Besa, FC Prishtina, KF Drenica, së fundi në KF Flamurtari, do të na ndihmojë në projektin tonë për rikthim. Ne i dëshirojmë mirëseardhje dhe i urojmë suksese në objektivat tona të përbashkëta”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Vushtrisë.

Broja: Kjo është arsyeja pse e zgjedha ofertën e Dritës

Rron Broja është goditja më e madh FC Dritës gjatë kësaj vere. Ish-futbollisti i Trepçës '89, së fundmi pjesë e Partizanit të Tiranës, zyrtarisht është rikthyer në futbollin e Kosovës. Mitrovicasi në mesin e disa ofertave joshëse, zgjodhi nënkampionët e Kosovës. Borja për “GazetaGoli” ka treguar arsyen pse zgjodhi skuadrën gjilanasë. “Është klub i organizuar në të gjitha aspektet. Kjo është arsyeja pse zgjedha Dritën”, ka thënë Broja. Ai ka zbuluar objektivat te Drita, skuadër kjo që ditë më parë u eliminua nga UEFA Conference League, pasi u mund nga gjiganti holandez Feyenoord. “Objektivat e mia te Drita janë që ta jap maksimumin në këtë klub të madh. Synojmë të shkojmë sa më lart në sezonin e ri”, ka shtuar Broja. Ndryshe, Drita konsiderohet një nga skuadrat favorite në garën për titull të kampionit në kampionatin e ardhshëm.

Kuka: Me pak fat do t'i kishim tri medalje olimpike

PEJË, 4 GUSHT - Akil Gjakova ishte një prej pesë xhudistëve të Kosovës që mori pjesë në Lojërat Olimpike. Xhudisti pejan bëri paraqitje të mira dhe përfundoi në vendin e shtatë, por nuk arriti të fitonte medalje si motra e tij, Nora Gjakova dhe garuesja tjetër Distria Krasniqi.

Trajnerit Driton Kuka i ka mbetur merak medalja e Akilit, pasi ai ishte shumë afër

ta fitonte atë. Sidoqoftë, trajneri i suksesshëm e ka përgëzuar garuesin e tij për paraqitjet dhe thotë se për të, Akili veçse është një medalist olimpik. “Akil Gjakova vendi 7 në Lojëra Olimpike! Ju deshën tri fitore për të ardhur në 8-shen e parë. Ishte i shkëlqyeshëm në çdo aspekt. Medaljet e Disit e Norës e qitën Akilin pak nën hije, por rezultati i tij është

i jashtëzakonshëm! Me pak fat do të kishim medaljen e tretë për ekipin tonë, por do të vazhdojë tutje Akili i cili sivjet rrëmbeu titullin e Kampionit Evropian. Akil, për mua je medalist, sepse medaljen e meritove. Fati sportiv ishte pak kundër nesh, por do të vazhdojmë tutje!”, ka shkruar Kuka në profilin e vet në “Facebook”.



Van Gaali për herë të tretë emërohet trajner i Holandës

Amsterdam, 4 gusht - Ashtu siç pritej, Luis Van Gaal është trajneri i ri i kombëtares së Holandës. 69-vjeçari rikthehet kështu në stolin e "tulipanëve", teksa ka firmosur të mërkurën kontratë njëvjeçare.

Van Gaal e ka drejtuar edhe dy herë të tjera Holandën. Bëhet fjalë për vitet 2000-2002 si dhe 2012-2014. Kjo është hera e tretë që merr drejtimin e kombëtares së vendit të tij. "Luis van Gaal është

zyrtarisht përzgjedhësi ynë. Ai do ta nisë punën menjëherë si trajner i Holandës. Kemi arritur marrëveshje deri në Kupën e Botës 2022", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të

Holandës. Van Gaali shkroi historinë me Ajaxin, ekip me të cilin fitoi Ligën e Kampionëve (1995), teksa ka drejtuar edhe klube si Barcelona, Bayern Munchen apo Manchester



Partizani, afër marrëveshjes me Migjen Bashën

Tiranë, 4 gusht - Migjen Basha është shumë pranë kalimit te Partizani. Ish-mesfushori i Kombëtares kuqezi, në një intervistë për "Panorama Sport", pranoi se është gati të rikthehet në Shqipëri dhe të luajë në Superiore. "Mua më duket sikur çdo vit del emri im në Shqipëri (qesh...). E vërteta është se deri këtë vit nuk ka pasur asnjëherë diçka konkrete. Po, është e vërtetë që kam biseduar me disa drejtues nga Shqipëria, por edhe nga Kosova. Nuk di nëse deri në fund të merkatos do të ketë apo jo diçka konkrete për ta finalizuar. Ndoshta një përvojë në Shqipëri do të jetë e mirë. Ta shohim", ka thënë Basha.

34-vjeçari me shumë përvojë ka pasur bisedime me klubin e Partizanit. Gazeta mëson se bisedimet mes tij dhe stafit drejtues të "demave" kanë qenë pozitive dhe ka pasur edhe një pajtim mes palëve. Deri më tani te Partizani ka pasur disi ngurrim për shkak të moshës së mesfushorit, por trajneri Daja dhe stafi teknik pret që në ekip të afrohen edhe lojtarë me përvojë, të cilët mund të vijnë direkt dhe të bëjnë diferencën në formacionin startues. Gjithashtu, edhe alternativat në mesfushën e



Partizanit janë të pakta dhe me mungesë përvojë. Kujtojmë se gjatë kësaj merkatoje vere u larguan edhe emrat si Broja, Hasani dhe Bardhi.

Bolt sulmon kampionin italian: Është qesharak



ROME, 4 GUSHT - Fitorja e medaljes së artë nga Marcell Jacobs vazhdon të shkaktojë debate. Pas akuzave për doping nga shtypi britanik, ka ardhur një sulm i ashpër nga ana e kampionit Usain Bolt, legjendë e gjallë e atletikës ndërkombëtare. Xhamajkani ka kritikuar italianin për këpucët e përdorura në garën e 100 metrave,

duke e përshkruar zgjedhjen e Jaobs si "e çuditshme dhe e padrejtë" dhe "qesharake" sepse, sipas tij, ndihmojnë shumë në paraqitjen e atletit që i vesh. Çfarë kanë të veçantë këto këpucë? Një efekt super elastik, që e bën më efikase forcën shtytëse dhe koordinimin e lëvizjeve të vrapuesit. Ato të përdorura nga Jacobs



peshonin 174 gramë, kishin një super majë dhe një take të gjerë 20 milimetra. Piastra prej karboni e futur në shollë është pak më e gjerë se shputa e këmbës. Një detaj ky që shton sipërfaqen e kontaktit mes gjymtyrës dhe pistës, duke garantuar një stabilitet më të mirë dhe duke favorizuar shpejtësinë dhe progresin.

SHKURT

Tërmet 6 ballë në Lojërat Olimpikë

Një tërmet i fuqishëm 6 ballë tronditi fshatin Olimpik të Tokios, ku është duke u mbajtur Olimpiada. Për fat të mirë, nuk raportohen dëme. Tërmeti goditi brigjet e Tokios rreth orës 5:30 të mëngjesit me orën lokale. Autoritetet përkatëse kanë përjashtuar mundësinë e shkakut të ndonjë cunami, duke qetësuar banorët. Dridhjet e forta mësohet të kenë zgjatur për rreth 30 sekonda por, për fat të mirë, ky tërmet nuk solli pasoja.

Kamberi paraqitet te Sheffield Wednesday

Florian Kamberi bën një tjetër hap mbrapa në karrierën e tij duke u transferuar në League One, kategoria e tretë e futbollit anglez. Gjithsesi sulmuesi i kombëtares shqiptare i cili në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar luajti i huazuar te Aberdeen në Skoci, pa realizuar asnjë gol, është transferuar te një skuadër me emër të madh në futbollin anglez siç është Sheffield Wednesday që këtë sezon milton në League One. Kamberi është transferuar në Angli në formë huazimi për një vit nga zvicëranët e St Gallen të cilët zotërojnë kartonin e tij. Sulmuesi shqiptar më parë ka luajtur edhe për skuadra si Grasshoppers, Karlsruher, Hibernian e Glasgow Rangers.

Ronaldo pëlqen rikthimin në Real Madrid

Cristiano Ronaldo ka shprehur dëshirë të largohet nga Seria A dhe të rikthehet në Real Madrid. "AS" raporton se 36-vjeçari ëndërron rikthimin në "Santiago Bernabeu" edhe pse është në dijeni që një gjë e tillë do të varet vetëm nga Kylian Mbappe. Nëse ylli iu i PSG-së vendos të transferohet në Real, Ronaldo duhet të mendojë për opsione të tjera. Ronaldo në vitin 2018 është transferuar në Juventus.

Ibiseviqi pensionohet si futbollist, fillon karrierën si trajner

Vedad Ibiseviq lë futbollin e luajtur dhe nis karrierën e trajnerit. 36-vjeçari boshnjak, të cilit sapo i ka përfunduar kontrata me Schalken, në fakt ka vendosur të kthehet te Hertha Berlin në një rol të ri. Ibiseviqit do t'i besohet detyra e stërvitjes së sulmuesve të skuadrës berlineze. Përvoja e tij e madhe do t'u vlejë lojtarëve ofensivë të Herthas për të qenë sa më efektivë para portës.

Interi refuzon ofertën e Chelseat për Lukakun

Chelsea kërkon ta rikthejë Romelu Lukakun në "Stamford Brige". Sulmuesi belg është kthyer në objektivin kryesor të Kampionëve të Evropës, që dëshirojnë një sulmues

të fuqishëm. Blutë e Londrës kërkojnë të përfitojnë nga situata e vështirë financiare e Interit. Klubi londinez ka paraqitur deri më tani një ofertë prej 100 milionë eurosh, e

cila është refuzuar nga zikaltrit. Chelsea tentoi edhe një herë duke shtuar në ofertë edhe Marcos Alonson, por sërish hasi në refuzimin e Interit. Tashmë skuadra

e Tuchel mund të mendojë edhe për një alternativë, teksa mund të bëhen edhe oferta për Harry Kane apo Erling Haaland, dy pista shumë të vështira.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel.+381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr. 84 me Nr. Protokollit datës 04.08.2021 të Kryeshefi Ekzekutiv, u vendos që me datë 05.08.2020 të shpallët:

Konkurs publik

Për këto pozita:

I. INKASANT

Numri: 1 /një/ INKASANT me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

I përgjigjet: Koordinatorit Faturimit dhe Inkasimit.

Vendi: Gjakovë.

Kushtet:

1. Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme preferohet drejtimi ekonomik,
2. Të ketë më së paku 1 (një) vite përvojë të punës relevante,

Kushtet e veçanta:

1. Të ketë njohuri profesionale ose të ngjashme,
2. Të mos jetë i dënuar apo nën hetime,
3. Të ketë aftësi të mira psikofizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës,
4. Preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma, Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurron, Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i/e dënuar (më e re se gjashtë muaj), preferohet të posedoj patentë shoferin me kategori "B" dhe Letër Njoftimi.

II. Punëtorë fizik sezonal, me kohë të caktuar

Numri: 2 /dy/

I përgjigjet: Menaxherit të Operativës.

Vendi: Gjakovë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë përgatitje- Shkollim Fillor i domosdoshëm;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune;

Kushtet e veçanta:

- Të jetë në gjendje të miri shëndetësore,
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Certifikata e mjekut, preferohet.

Paga për këto të dy pozitat: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Detyrat e punës: Për të këto pozita detyrat e punës mund t'i gjeni në veb faqen e kompanisë cabrati.com

Afati i paraqitjes së kërkesave për këto dy pozita është 15 ditë nga dita e publikimit, (nga data 05.08.2021 e deri me datë 19.08.2021 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek sekretaria- Menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së të testit dhe intervistës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hysni Zajmi" Gjakovë

► Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Feraset Asllani, Berjahë Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.M.M.U. "Bajram Sadriu" Berjahë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

